



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Qeveria – Vlada – Government

**RREGULLORE (ZKM) – NR. 01/2026 PËR ORGANIZIMIN E
BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS PËR
AGJENCINË E INVESTIMEVE DHE EKSPORTEVE¹**

¹ Rregullore (ZKM) Nr. 01/2026 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës për Agjencinë e Investimeve dhe Eksporteve, miratuar me Vendimin Nr.342/2026, të datës 14.01.2026.

Kryeministri i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 94 (3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 9 (3) dhe 28 (3) të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 19 (7) të Ligjit Nr. 08/L-209 për Investime të Qëndrueshme, nenit 9 (1.11) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe nenit 9 (7) të Rregullores (QRK) Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura, nxjerr:

RREGULLORE (ZKM) – NR. 01/2026 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS PËR AGJENCINË E INVESTIMEVE DHE EKSPORTEVE

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë e Investimeve dhe Eksporteve.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet nga Agjencia e Investimeve dhe Eksporteve e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Neni 3 Përkufizimet

Termat e përdorur në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë me terminologjinë e përdorur në ligjin përkatës për investime të qëndrueshme dhe ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura.

Neni 4 Misioni i Agjencisë së Investimeve dhe Eksporteve

1. Agjencia e Investimeve dhe Eksporteve (tani e tutje: AIE) ka për qëllim promovimin, dhe rritjen e investimeve dhe eksporteve në Republikën e Kosovës. Në misionin e saj, AIE udhëhiqet nga parimet e investimit të përgjegjshëm të mbështetura nga Kombet e Bashkuara dhe nga deklarata dhe vendimet për investimet ndërkombëtare dhe ndërmarrjet shumëkombëshe të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD).

2. AIE zhvillon, monitoron dhe raporton tregues të performancës për tërheqjen e investimeve, rritjen e eksporteve, krijimin e vendeve të punës dhe kënaqësinë e investitorëve, në përputhje me objektivat shtetërore të përcaktuara me ligj.

Neni 5

Struktura organizative e AIE-së

1. Struktura organizative e AIE-së është si vijon:
 - 1.1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv;
 - 1.2. Departamentet; dhe
 - 1.3. Divizionet.
2. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në AIE është gjashtëdhjetë e shtatë (67).

Neni 6

Zyra e Drejtorit Ekzekutiv të AIE-së

1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv të AIE-së përbëhet nga:
 - 1.1. Drejtori Ekzekutiv;
 - 1.2. Zëvendës-Drejtori Ekzekutiv;
 - 1.3. Një (1) zyrtar i lartë ekzekutiv;
 - 1.4. Një (1) zyrtar i lartë certifikues; dhe
 - 1.5. Një (1) zyrtar administrativ.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv dhe të Zëvendës-Drejtorit Ekzekutiv përcaktohen në pajtim me ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura si dhe ligjin përkatës për investime të qëndrueshme.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve të lartë ekzekutiv dhe zyrtarëve administrativ përcaktohen në pajtim me ligjin përkatës për zyrtarë publik.
4. Numri i të punësuarve në Zyrën e Drejtorit Ekzekutiv është pesë (5).

Neni 7

Departamentet dhe Divizionet e AIE-së

1. Në kuadër të AIE-së funksionojnë departamentet dhe divizionet vijuese:
 - 1.1. Zyra për Promovimin e Investimeve dhe Eksportit:
 - 1.1.1. Divizioni i Promovimit të Investimeve; dhe
 - 1.1.2. Divizioni i Promovimit të Eksportit.

1.2. Zyra për Hulumtim dhe Zhvillim të Sektorëve:

1.2.1. Divizioni për Hulumtim dhe Analizë të Sektorëve; dhe

1.2.2. Divizioni për Zhvillim të Sektorëve.

1.3. Zyra për Shërbime (One-stop-shop):

1.3.1. Divizioni për Lehtësim;

1.3.2. Divizioni për Investime Strategjike; dhe

1.3.3. Divizioni për Kujdesin Pasues.

1.4. Zyra Ligjore

1.4.1. Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit; dhe

1.4.2. Divizioni për Këshillimin Ligjor në Fushën e Investimeve dhe Eksporteve.

1.5. Divizioni për Buxhet dhe Financa.

1.6. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

1.7. Divizioni për Prokurim Publik.

1.8. Njësia e Auditimit të Brendshëm.

1.9. Divizioni për Teknologji Informative, Logjistikë dhe Arkivim.

1.10. Divizioni për Komunikim dhe Marketing.

Neni 8

Zyra për Promovimin e Investimeve dhe Eksportit

1. Zyra për Promovimin e Investimeve dhe Eksportit ka për mision të tërheqë dhe lidhë investitorët me mundësitë e investimit në Kosovë, duke promovuar potencialin investues në vend, krijimin e kontakteve, lehtësimin e qasjes në informacion, duke kontribuar në krijimin e një mjedisi të favorshëm për investitorët, në përputhje me objektivat shtetërore dhe sektorët prioritarë. Poashtu, Zyra për Promovimin e Investimeve dhe Eksportit ka për mision të rrisë praninë tregtare të Kosovës në nivel global duke promovuar eksportin e produkteve dhe shërbimeve konkurruese dhe cilësore dhe duke lehtësuar qasjen në tregjet ndërkombëtare për eksportuesit nga Kosova.

2. Zyra për Promovimin e Investimeve dhe Eksportit ka detyrat dhe përgjegjësitë vijuese:

2.1. Mbledhja e informacionit të përditësuar mbi trendet e investimeve dhe identifikimi i segmenteve premtuese për të realizuar promovimin e investimeve;

2.2. Zhvillimi dhe menaxhimi i fushatave promovuese me synimin për të kontaktuar

investitorët potencial;

2.3. Organizimi i ngjarjeve në bashkëpunim me partnerët për të arritur tek audienca e synuar për rritje të investimeve;

2.4. Promovimi përmes panairove dhe ngjarjeve tregtare;

2.5. Krijimi dhe mbajtja e një rrjeti të ndërmjetësve brenda Kosovës dhe në nivel ndërkombëtar;

2.6. Hulumtimin e përparësive konkurruese për produktet me potencial eksporti në tregjet ndërkombëtare;

2.7. Krijimin, zyrtarizimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave shtetërore të eksportuesve;

2.8. Ofrimin e informacionit individual dhe shërbimeve këshillimore;

2.9. Organizimin e ngjarjeve për të ndihmuar eksportuesit në gjetjen e blerësve dhe partnerëve;

2.10. Targeton partnerë potencialë ndërkombëtar me qëllim të gjenerimit të kontakteve dhe mundësive të reja të bashkëpunimit;

2.11. Zhvillimin e mjeteve të marketingut për t'iu adresuar blerësve potencialë në tregjet e eksportit dhe kompanitë vendase;

2.12. Krijimin dhe mirëmbajtjen e një rrjeti të ndërmjetësve brenda Kosovës dhe në nivel ndërkombëtar;

2.13. Identifikimin e sfidave të kompanive eksportuese dhe ofrimi i tyre në proceset përkatëse të planifikimit, në koordinim me ministritë përkatëse;

2.14. Hartimin e planeve dhe zhvillimin e aktiviteteve vjetore në përputhje me kërkesat për zgjerimin e tregjeve për eksport;

2.15. Mbikëqyrë punën e kompanive të përzgjedhura për të promovuar mundësitë e eksportit;

2.16. Zhvillimin dhe zbatimin e programeve për angazhimin e diasporës në investime dhe eksporte, përfshirë identifikimin e investitorëve dhe eksportuesve potencial nga diaspora, ndërlidhjen me partnerë tregtarë ndërkombëtarë dhe promovimin e investimeve të diasporës në sektorët prioritarë.

3. Drejtori i Zyrës për Promovimin e Investimeve dhe Eksportit raporton tek Drejtori Ekzekutiv i AIE-së.

4. Zyra për Promovimin e Investimeve dhe Eksportit është e barasvlefshme me departament.

5. Në kuadër të Zyrës për Promovimin e Investimeve dhe Eksportit bëjnë pjesë divizionet vijuese:

5.1. Divizioni i Promovimit të Investimeve; dhe

5.2. Divizioni i Promovimit të Eksportit.

6. Numri i të punësuarve në Zyrën për Investime dhe Eksport është trembëdhjetë (13).

Neni 9

Divizioni i Promovimit të Investimeve

1. Divizioni i Promovimit të Investimeve ka për mision të tërheqë dhe lidhë investitorët me mundësitë e investimit në Kosovë, duke promovuar potencialin investues në vend, krijimin e kontakteve, lehtësimin e qasjes në informacion, si dhe duke kontribuar në krijimin e një mjedisi të favorshëm për investitorët, në përputhje me objektivat shtetërore dhe sektorët prioritarë.

2. Divizioni i Promovimit të Investimeve ka detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

2.1. Mbledhja e informacionit të përditësuar mbi trendet e investimeve dhe identifikimi i segmenteve premtuese për të realizuar promovimin e investimeve;

2.2. Zhvillimi dhe menaxhimi i fushatave promovuese me synimin për të kontaktuar investitorët potencial;

2.3. Organizimi i ngjarjeve në bashkëpunim me partnerët për të arritur tek audienca e synuar për rritje të investimeve;

2.4. Promovimi përmes panairove dhe ngjarjeve tregtare;

2.5. Targeton investitorët potencialë me qëllim të gjenerimit të pistave (leads);

2.6. Krijon dhe mban marrëdhënie të forta me palët kryesore, duke përfshirë organizatat tregtare/biznesore, shoqatave të industrisë, odat, dhomat kryesore të tregtisë, agjencitë qeveritare relevante në vendet përkatëse;

2.7. Krijimi dhe mbajtja e një rrjeti të ndërmjetësve brenda dhe jashtë Kosovës;

2.8. Mbikëqyrë punën e kompanive të përzgjedhura për të promovuar mundësitë e investimeve në Kosovë nga investitorët e jashtëm.

3. Udhëheqësi i Divizionit të Promovimit të Investimeve raporton tek Drejtori i Zyrës Promovimin e Investimeve dhe Eksportit.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin e Promovimit të Investimeve është shtatë (7).

Neni 10

Divizioni i Promovimit të Eksportit

1. Divizioni i Promovimit të Eksportit ka për mision të rrisë praninë tregtare të Kosovës duke

promovuar eksportin e produkteve dhe shërbimeve konkurruese dhe cilësore dhe duke lehtësuar qasjen në tregjet ndërkombëtare për eksportuesit nga Kosova.

2. Divizioni i Promovimit të Eksportit ka detyrat dhe përgjegjësitë vijuese:

- 2.1. Hulumtimin e përparësive konkurruese për produktet me potencial eksporti në tregjet e jashtme;
- 2.2. Krijimin, zyrtarizimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave shtetërore të eksportuesve në tregjet e jashtme;
- 2.3. Ofrimin e informacionit individual dhe shërbimeve këshillimore për eksportuesit në tregjet e jashtme;
- 2.4. Organizimin e ngjarjeve për të ndihmuar eksportuesit në gjetjen e blerësve dhe partnerëve në tregjet e jashtme;
- 2.5. Targeton partnerë potencialë në shtetet e jashtme me qëllim të gjenerimit të kontakteve afariste dhe krijimit të mundësive të reja të bashkëpunimit.
- 2.6. Zhvillimin e mjeteve të marketingut për t'iu adresuar blerësve potencialë në tregjet e eksportit dhe kompanitë vendase për eksportin jashtë Kosovës;
- 2.7. Krijimin dhe mirëmbajtjen e një rrjeti të ndërmjetësve brenda Kosovës dhe jashtë saj për të promovuar eksportin;
- 2.8. Identifikimin e sfidave të kompanive eksportuese dhe ofrimin e mbështetjes në proceset përkatëse të planifikimit, në koordinim me institucionet përkatëse;
- 2.9. Hartimin e planeve dhe zhvillimin e aktiviteteve vjetore në përputhje me kërkesat për zgjerimin e tregjeve për eksport në shtetet e jashtme;
- 2.10. Mbikëqyrë punën e kompanive të përzgjedhura për të promovuar mundësitë e eksportit në shtetet e jashtme.

3. Udhëheqësi i Divizionit të Promovimit të Eksportit raporton tek Drejtori i Zyrës për Promovimin e Investimeve dhe Eksportit.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin e Promovimit të Eksportit është pesë (5).

Neni 11

Zyra për Hulumtim dhe Zhvillim të Sektorëve

1. Zyra për Hulumtim dhe Zhvillim të Sektorëve ka për mision të mbështesë zhvillimin dhe promovimin e sektorëve prioritarë duke ofruar njohuri dhe ekspertizë përmes zhvillimit të analizave sektoriale dhe krijimit të partneriteteve me akterët kyq sektorialë.

2. Zyra për Hulumtim dhe Zhvillim të Sektorëve ka detyrat dhe përgjegjësitë vijuese:

- 2.1. Të analizojë të dhëna sektoriale për të përditësuar bazat e të dhënave dhe për të mbështetur vendimmarrjen;
 - 2.2. Kryerja e hulumtimeve dhe analizave të tregut për të identifikuar trende, sfida dhe mundësi brenda sektorëve të caktuar;
 - 2.3. Ofrimi i ekspertizës së specializuar mbi trendet dhe dinamikat e ekosistemit sektorial për sektorët e caktuar;
 - 2.4. Të ndërtojë dhe mirëmbajë marrëdhënie të forta me aktorët kryesorë të industrive, sektorëve dhe shoqërive tregtare;
 - 2.5. Të lehtësojë dialogun dhe bashkëpunimin ndërmjet palëve të interesuara për të adresuar sfidat sektoriale dhe për të promovuar inovacionin;
 - 2.6. Të ofrojë njohuri për kërkesat ligjore dhe administrative të aplikueshme për sektorët e caktuar.
3. Drejtori i Zyrës për Hulumtim dhe Zhvillim të Sektorëve raporton tek Drejtori Ekzekutiv i AIE-së.
 4. Zyra për Hulumtim dhe Zhvillim të Sektorëve është e barasvlefshme me departament.
 5. Në kuadër të Zyrës për Hulumtim dhe Zhvillim të Sektorëve bëjnë pjesë divizionet vijuese:
 - 5.1. Divizioni për Hulumtim dhe Analizë të Sektorëve; dhe
 - 5.2. Divizioni për Zhvillim të Sektorëve.
 6. Numri i të punësuarve në Zyrën për Hulumtim dhe Zhvillim të Sektorëve është njëmbëdhjetë (11).

Neni 12

Divizioni për Hulumtim dhe Analizë të Sektorëve

1. Divizioni për Hulumtim dhe Analizë të Sektorëve ka për mision të hulumtojë dhe analizojë sektorët me qëllim mbështetjen e vendimmarrjes së AIE-së për promovimin e investimeve dhe eksportit, duke ofruar njohuri dhe ekspertizë përmes zhvillimit të analizave sektoriale dhe krijimit të partneriteteve me akterë kyq sektorialë.
2. Divizioni për Hulumtim dhe Analizë të Sektorëve ka detyrat dhe përgjegjësitë vijuese:
 - 2.1. Të analizojë të dhëna të sektorëve për të përditësuar bazat e të dhënave dhe për të mbështetur vendimmarrjen;
 - 2.2. Kryerja e hulumtimeve dhe analizave të tregut për të identifikuar trende, sfida dhe mundësi brenda sektorëve;
 - 2.3. Ofrimi i ekspertizës së specializuar mbi trendet dhe dinamikat e ekosistemit sektorial;

2.4. Të ndërtojë dhe mirëmbajë marrëdhënie të forta me aktorët kryesorë të industrisë, sektorit dhe shoqërive tregtare;

2.5. Të lehtësojë dialogun dhe bashkëpunimin ndërmjet palëve të interesuara për të adresuar sfidat sektoriale dhe për të promovuar inovacionin sektorët e ndryshëm;

2.6. Të ofrojë njohuri për kërkesat ligjore dhe administrative të aplikueshme për sektorë.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Hulumtim dhe Analizë të Sektorëve raporton tek Drejtori i Zyrës për Hulumtim dhe Zhvillim të Sektorëve.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Hulumtim dhe Analizë të Sektorëve është pesë (5).

Neni 13

Divizioni për Zhvillim të Sektorëve

1. Divizioni për Zhvillim të Sektorëve ka për mision të mbështesë zhvillimin e sektorëve dhe krijimi të partneriteteve me akterët kyq sektorialë.

2. Divizioni për Zhvillim të Sektorëve ka detyrat dhe përgjegjësitë vijuese:

2.1. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave mbi sektorët;

2.2. Vlerësimi i potencialeve, sfidave dhe trendeve të secilit sektor për të identifikuar mundësitë e zhvillimit;

2.3 Hartimi i profileve sektoriale që përmbajnë të dhëna kyçe, tregues ekonomikë dhe informacion mbi konkurrueshmërinë e sektorëve;

2.4. Analiza krahasuese e performancës së sektorëve me tregjet rajonale dhe ndërkombëtare;

2.5. Përgatitja e raporteve analitike për ndikimin e faktorëve ekonomikë, mjedisorë dhe tregtarë mbi sektorët;

2.6. Krijimi dhe mirëmbajtja e partneriteteve të bashkëpunimit me institucionet publike, bizneset, organizatat sektoriale dhe partnerët ndërkombëtarë.

2.7. Mbështetjen e investimeve në hulumtim dhe zhvillim, transfer të teknologjisë, integrim në zinxhirët vendorë dhe globalë të vlerës, si dhe rritjen e përmbajtjes vendore në sektorët prioritarë.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Zhvillim të Sektorëve raporton tek Drejtori i Zyrës për Hulumtim dhe Zhvillim të Sektorëve.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Zhvillim të Sektorëve është pesë (5).

Neni 14

Zyra për Shërbime (One-stop Shop)

1. Zyra për Shërbime ka për mision ofrimin e shërbimeve efikase të kujdesit ndaj investitorëve në mënyrë të vazhdueshme gjatë çdo faze të investimit, duke siguruar lehtësimin të procesit të investimeve, kujdesin pasues si dhe procesimin e propozimeve për investime strategjike.

2. Zyra për Shërbime ka detyrat dhe përgjegjësitë vijuese:

2.1. Lehtësimin e investimeve që nënkupton shërbimet e asistencës së investitorëve, ashtu siç përcaktohet me aktin nënligjor përkatës për shërbimet e kujdesit ndaj investitorëve, duke përfshirë ofrimin e informatave:

2.1.1. mbi mjedisin ekonomik dhe mbi mundësitë e investimeve në sektorët prioritarë dhe trendet e zhvillimit;

2.1.2. mbi kërkesat rregullative dhe administrative të sektorëve me interes për investitorin;

2.1.3. vendet e disponueshme për investime, përfshirë këtu parcelat dhe objektet e disponueshme përmes hartave digjitale, si dhe organizimin e vizitave në terren;

2.1.4. Koordinimin dhe strukturimin e paketave të nxitjes së investimeve, në përputhje me nenin 16 të Ligjit Nr. 08/L-209 për Investime të Qëndrueshme, duke përfshirë lehtësirat fiskale, subvencionet, përkrahjen për aftësim dhe punësim, përkrahjen për hulumtim dhe zhvillim, si dhe ndërlidhjen me instrumentet financiare vendore dhe ndërkombëtare, në bashkëpunim me institucionet kompetente;

2.1.5. mundësitë për qasjen në parqe industriale dhe teknologjike për investimet që përmbushin objektivat shtetërore;

2.1.6. mundësitë e lidhjes së autoriteteve publike relevante me partnerët e mundshëm të biznesit;

Si dhe ofrimin e mbështetjes në lidhje me:

2.1.7. regjistrimin e biznesit, duke njoftuar investitorët me procedurat që duhet ndjekur si dhe duke lehtësuar komunikimin në mes investitorit dhe Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë;

2.1.8. procedurat e marrjes së lejeve dhe licencave, pëlqimeve, autorizimeve dhe akteve të ngjajshme, duke e njoftuar investitorët mbi procedurat e aplikueshme sipas ligjeve përkatëse si dhe duke lehtësuar komunikimin në mes investitorit dhe autoritetit publik kompetent;

2.1.9. zgjedhjen e vendeve të investimit, duke e njoftuar me pronat publike të cilat janë në dispozicion për investitorë, si dhe duke e vendosur në kontakt me autoritetin publik kompetent për alokimin e asaj prone për shfrytëzim nga investitori;

2.1.10. qasjen në parqe industriale dhe teknologjike për investitorët që përmbushin objektivat shtetërore ose janë pjesë e sektorëve prioritarë, duke u siguruar qasje të

shpejtë në këtë infrastrukturë në bashkëpunim me AIPNK;

2.1.11. ndërlidhjen e investorëve me autoritet publike relevante si dhe partnerët e mundshëm të biznesit;

2.1.12. gjetjen e fuqisë së duhur punëtore përmes ndërlidhjes me universitete dhe institucionet e akredituara për aftësim profesional.

2.2. Kujdesin pasues për investorë që nënkupton shërbimet e mbështetjes për investorë ekzistues, ashtu siç përcaktohet me aktin nënligjor përkatës për shërbimet e kujdesit ndaj investorëve, duke përfshirë:

2.2.1. organizimit të takimeve të rregullta individuale me investorët ekzistues për të diskutuar projektet e mëparshme dhe të planifikuara, sfidat dhe mbështetjen e nevojshme;

2.2.2. ofrimit të informatave në lidhje me kërkesat rregullatore dhe administrative të aplikueshme për projektet e tyre ekzistuese;

2.2.3. ofrimit të shërbimeve të lehtësimit me qëllim të zgjerimit të aktiviteteve;

2.2.4. mbajtjes së një databaze me rrjetin e partnerëve që ofrojnë shërbime mbështetëse për investorë;

2.2.5. anketimi mbi nevojat dhe përceptimet e investorëve për të identifikuar fushat ku nevojitet reformë që përmirëson mundësitë e investimeve;

2.2.6. zbatimin e programeve dhe projekteve vendore dhe ndërkombëtare që mbështesin kujdesin pasues për investorë;

2.2.7. lehtësimit të procesit të konsultimit në mes investorit dhe autoritetit publike, ose ofrimit të shërbimit publik në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas nenit 44 të Ligjit nr. 08/L-209 për Investime të Qëndrueshme.

2.3. Verifikimin plotësues të investimeve, siç përcaktohet me aktin nënligjor përkatës për verifikimin plotësues;

2.4. Pranon dhe shqyrton propozimet për investime strategjike, siç përcaktohet me aktin nënligjor përkatës;

2.5. Vlerëson dokumentacionin e propozimeve për investime strategjike, siç përcaktohet me aktin nënligjor përkatës;

2.6. Propozon paraqitjen para Këshillit për miratim, rekomandimin për shpallje, refuzimin ose revokimin e investimit strategjik;

2.7. Zhvillon dhe mirëmban platformë digjitale për të mbështetur procesin e shërbimeve të kujdesit ndaj investorëve.

3. Drejtori i Zyrës për Shërbime raporton tek Drejtori Ekzekutiv i AIE-së.

4. Zyra për Shërbime është e barasvlefshme me departament.
5. Në kuadër të Zyrës për Shërbime bëjnë pjesë divizionet vijuese:
 - 5.1. Divizioni për Lehtësim;
 - 5.2. Divizioni për Investime Strategjike; dhe
 - 5.3. Divizioni për Kujdesin Pasues.
6. Numri i të punësuarve në Zyrën për Shërbime është dhjetë (10).

Neni 15 **Divizioni për Lehtësim**

1. Divizioni për Lehtësim ka për mision ofrimin e shërbimeve efikase të kujdesit ndaj investitorëve në mënyrë të vazhdueshme gjatë çdo faze të investimit për të siguruar lehtësimin të procesit të investimeve.
2. Divizioni për Lehtësim ka detyrat dhe përgjegjësitë vijuese:
 - 2.1. Verifikimi plotësues i investitorëve dhe projekteve investuese;
 - 2.2. Sigurimi i informacionit me orientim nga klienti mbi karakteristikat përkatëse të mjedisit investues si dhe proceseve administrative të lidhura me investimet;
 - 2.3. Parazgjedhja e vendeve të investimit dhe organizimi i vizitave në terren në përshtatje të fushëveprimit;
 - 2.4. Lidhja e investitorëve, ndër të tjera, me autoritetet dhe institucionet publike qendrore dhe lokale, partnerët e mundshëm të biznesit;
 - 2.5. Ndihma e investitorëve për të gjetur punonjësit e duhur dhe lehtësimi i kontakteve me universitetet përkatëse dhe ofruesit e trajnimit;
 - 2.5. Ndihma me procedurat e regjistrimit të biznesit dhe aplikimet për leje dhe licenca;
 - 2.7. Navigimi dhe ndjekja e shpejtë e proceseve administrative për zgjidhje të strukturuar të problemeve me investitorë individualë;
3. Udhëheqësi i Divizionit për Lehtësim raporton tek Drejtori i Zyrës për Shërbime.
4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Lehtësim është tre (3).

Neni 16

Divizioni për Investime Strategjike

1. Divizioni për Investime Strategjike ka për mision të sigurojë vlerësimin efektiv, lehtësimin dhe mbikëqyrjen e projekteve të investimeve strategjike në Kosovë duke nxitur bashkëpunimin mes akterëve.

2. Divizioni për Investime Strategjike ka detyrat dhe përgjegjësitë vijuese:

2.1. Pranon propozimet për investime strategjike dhe vlerëson nëse projekti i propozuar është në pajtim me legjislacionin në fuqi;

2.2. Përgatitë dosjen për shqyrtimin e projektit investues;

2.3. Bën kërkimin e të dhënave dhe dokumenteve të nevojshme për shqyrtimin e propozimit;

2.4. Shqyrton propozimin me ndihmën e institucioneve kompetente dhe mbështetëse nga sektorët dhe përgjegjësit përkatës të investimit strategjik;

2.5. Propozon paraqitjen para Këshillit për miratim rekomandimin për shpallje, refuzimin ose revokimin e investimit strategjik. Konkretisht:

2.5.1. ofron rekomandim paraprak për shpalljen e investimit strategjik sipas propozimit, nëse gjatë shqyrtimit paraprak konstaton se propozimi përmbush kushtet dhe kriteret e parapara me ligjin përkatës për investime të qëndrueshme;

2.5.2. ofron rekomandim përfundimtar për shpalljen e investimit strategjik sipas propozimit, nëse gjatë shqyrtimit përfundimtar konstaton se propozimi përmbush kushtet dhe kriteret e parapara me ligjin përkatës për investime të qëndrueshme;

2.5.3. ofron rekomandim paraprak për refuzimin e investimit strategjik sipas propozimit, nëse gjatë shqyrtimit paraprak konstaton se propozimi nuk përmbush kushtet dhe kriteret e parapara me ligjin përkatës për investime të qëndrueshme;

2.5.4. ofron rekomandim përfundimtar për refuzimin e investimit strategjik sipas propozimit, nëse gjatë shqyrtimit përfundimtar konstaton se propozimi nuk përmbush kushtet dhe kriteret e parapara me ligjin përkatës për investime të qëndrueshme;

2.5.5. ofron rekomandim për miratimin ose refuzimin e projektit të përgatitur nga propozuesit përkatës për investim strategjik sipas nenit 29 të ligjit përkatës për investime të qëndrueshme;

2.5.6. ofron rekomandim tjetër të paraparë me legjislacionin në fuqi ose të kërkuar nga Këshilli me qëllim të zbatimit të dispozitave të ligjit përkatës për investime të qëndrueshme;

2.6. Në bashkëpunim me njësitë tjera administrative, ofron mbështetje për shërbimet ndaj investitorit sipas dispozitave të ligjit përkatës për investime të qëndrueshme;

2.7. Shqyrton projektet e përgatitura nga institucionet publike për investime strategjike në

sektorët prioritar;

2.8. Propozon rekomandimin përkatës tek Drejtori Ekzekutiv për t'u adresuar në Këshill si dhe bashkërendon punën e institucioneve publike në përgatitjen e projekteve të investimeve strategjike;

2.9. Monitoron dhe raporton për zbatimin e investimeve strategjike;

2.10. Bën verifikimin plotësues të investimeve të synuara dhe të kryera që potencialisht mund të prekin rendin publik ose sigurinë shtetërore dhe përmes Drejtorit Ekzekutiv, i paraqet Këshillit rekomandimet përkatëse;

2.11. Bën lehtësimin e konsultimit, vëzhgimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe kontesteve të investimit, si dhe rekomandon masa parandaluese në pajtim me kapitullin VII të ligjit përkatës për investime të qëndrueshme;

2.12. Bën propozimet për planet e veprimit, raportet dhe vendimet e Këshillit për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve dhe eksporteve;

2.13. Ofron shërbime tjera të parapara me aktin nënligjor përkatës për investime strategjik.

2.14. Ofron shërbime të sekretariatit për Këshillin për Investime dhe Panelin Ankimor.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Investime Strategjike raporton tek Drejtori i Zyrës për Shërbime.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Investime Strategjike është tre (3).

Neni 17

Divizioni për Kujdesin Pasues

1. Divizioni për Kujdesin Pasues ka për mision të mbështesë investitorët ekzistues duke ofruar asistencë të vazhdueshme dhe zgjidhje që ndihmojnë në rritjen dhe suksesin e tyre.

2. Divizioni për Kujdesin Pasues ka detyrat dhe përgjegjësitë vijuese:

2.1. Organizimi i rregullt i takimeve individuale me investitorët ekzistues për të diskutuar projektet e mëparshme dhe të planifikuara, sfidat dhe mbështetjen e nevojshme;

2.2. Qartëson, lehtëson dhe konsolidon proceset rreth kërkesave të investitorëve dhe eksportuesve të mundshëm, duke përfshirë por duke mos u kufizuar me udhëzimet e qarta veprimi të institucioneve përgjegjëse;

2.3. Mbështetja e investitorëve në përballje me procedurat administrative në lidhje me projektet e tyre investuese dhe eksportuese;

2.4. Ndihma e investitorëve dhe eksportuesve potencial për të zgjeruar aktivitetet e tyre duke përdorur sinergjitë me shërbimet e lehtësimit të investimeve dhe eksporteve;

2.5. Krijimi dhe mbajtja e një rrjeti partnerësh për shërbime për të ofruar një portofol gjithëpërfshirës të shërbimeve mbështetëse për investitorët;

2.6. Mbledhja e informacionit mbi nevojat dhe perceptimet e investitorëve dhe parashtrimi i tyre në këshilla për politikatat për reformat e klimës së investimeve;

2.7. Zbatimi i programeve kombëtare dhe projekteve ndërkombëtare që mbështesin masat e kujdesit pasues;

2.8. Përgatitjen e rekomandimeve të strukturuar për reforma ligjore, administrative dhe rregullative, bazuar në përvojën praktike dhe pengesat e identifikuara nga investitorët dhe eksportuesit, dhe adresimin e tyre tek institucionet përgjegjëse.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Kujdesin Pasues raporton tek Drejtori i Zyrës për Shërbime.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Kujdesin Pasues është tre (3).

Neni 18

Zyra Ligjore

1. Zyra Ligjore ka për mision të sigurojë që detyrat dhe përgjegjësitë e AIE-së ushtrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi gjatë planifikimit dhe zbatimit të tyre.

2. Zyra Ligjore ka detyrat dhe përgjegjësitë vijuese:

2.1. Ofrimi i këshillave dhe opinioneve ligjore, sqarimeve, raporteve dhe analizave ligjore për AIE-në;

2.2. Ofrimi i mbështetjes për hartimin e vendimeve, kontratave, akteve të tjera juridike, si dhe formularëve, udhëzuesve dhe mostrave për nevojat e AIE-së;

2.3. Vlerësimi nga pikëpamja ligjore i dokumenteve të përgatitura nga njësitë tjera të AIE-së, para miratimit të tyre nga Drejtori Ekzekutiv;

2.4. Përfaqësimi i AIE-së në procedurat ligjore në raport me palët e jashtme;

2.5. Monitorimi i ndryshimeve ligjore të cilat ndikojnë në funksionimin e AIE-së;

2.6. Pjesëmarrja në hartimin e legjislacionit që ndërlidhet me punën e AIE-së;

2.7. Ofrimi i këshillave për të siguruar zbatimin e drejtë dhe të saktë të legjislacionit në fuqi nga të gjitha njësitë e AIE-së;

2.8. Të avokojë me institucione përgjegjëse për ndryshime në politika dhe legjislacion në mbështetje të investimeve dhe eksporteve.

3. Udhëheqësi i Zyrës Ligjore i raporton Drejtorit Ekzekutiv të AIE-së.

4. Zyra Ligjore është e barasvlefshme me departament.

5. Në kuadër të Zyrës Ligjore bëjnë pjesë divizionet vijuese:

5.1. Divizioni për Mbikëqyrje të Zbatimit të Legjislacionit; dhe

5.2. Divizioni për Këshillimin Ligjor në Fushën e Investimeve dhe Eksporteve.

6. Numri i të punësuarve në Zyrën Ligjore, është shtatë (7).

Neni 19

Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit

1. Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit ka për mision vlerësimin e konformitetit të aktiviteteve dhe vendimeve të AIE-së me legjislacionin në fuqi, mbikëqyrjen e të vepruarit dhe të zbatuarit të standardeve ligjore dhe promovimin e sundimit efektiv të ligjshmërisë.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit janë:

2.1. Koordinon aktivitetet me të gjitha strukturat organizative të AIE-së për zbatimin e legjislacionit;

2.2. Ofron mbështetje ligjore në fushën e legjislacionit;

2.3. Identifikon problemet e zbatimit të akteve normative;

2.4. Koordinon aktivitetet legjislative të AIE-së me institucionet përkatëse;

2.5. Përfaqëson AIE-në në procedurat ligjore në raport me palët e jashtme;

2.6. Vlerësimi nga pikëpamja ligjore i dokumenteve të përgatitura nga njësitë tjera të AIE-së, para miratimit të tyre nga Drejtori Ekzekutiv.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Mbikëqyrje të Zbatimit të Legjislacionit raporton tek Drejtori i Zyrës Ligjore.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Mbikëqyrje të Zbatimit të Legjislacionit është tre (3).

Neni 20

Divizioni për Këshillimin Ligjor në Fushën e Investimeve dhe Eksporteve

1. Divizioni për Këshillimin Ligjor në Fushën e Investimeve dhe Eksporteve ka për mision ofrimin e këshillave juridike për të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me investime dhe eksporte.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Këshillimin Ligjor në Fushën e Investimeve dhe Eksporteve janë:

2.1. Ofron mbështetje ligjore brenda AIE-së në hartimin e propozim-vendimeve, propozim-marrëveshjeve, propozim-memorandumeve dhe propozim-kontratave lidhur me investitorët

strategjik;

2.2. Ofron mbështetje ligjore brenda AIE-së në navigimin e kërkesave ligjore për zhvillimin e aktiviteteve afariste si dhe pajisjen me leje dhe liçenca për investime;

2.3. Ofron mbështetje ligjore lidhur me kërkesat dhe rregullativën ligjore të eksporteve, për AIE;

2.4. Të avokojë me institucione përgjegjëse për ndryshime në politika dhe legjislacion në mbështetje të investimeve dhe eksporteve.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Këshillimin Ligjor në Fushën e Investimeve dhe Eksporteve raporton tek Drejtori i Zyrës Ligjore.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Këshillimin Ligjor në Fushën e Investimeve dhe Eksporteve është tre (3).

Neni 21

Divizioni për Buxhet dhe Financa

1. Divizioni për Buxhet dhe Financa ka për mision planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit në përputhje me ligjin përkatës për menaxhimin e financave publike dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

2. Divizioni për Buxhet dhe Financa ka detyrat dhe përgjegjësitë vijuese:

2.1. Planifikimi i buxhetit të AIE-së në koordinim me njësitë e tjera organizative;

2.2. Propozimi i buxhetit për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), në harmoni me kërkesat e paraqitura nga AIE-ja;

2.3. Përgatitja e projekt buxhetit vjetor të AI-së në përputhje me dokumentet planifikuese;

2.4. Krijimi i programeve/nën programeve në bazë të kërkesave të njësive organizative, në bashkëpunim me Departamentin e Buxhetit në ministrinë përgjegjëse për financa;

2.5. Zbatimi i standardeve të kontabilitetit mbi mbajtjen e evidencës kontabël;

2.6. Kontabiliteti për zotimet dhe pagesat, si dhe regjistrimi i të gjitha zotimeve dhe pagesave;

2.7. Bashkërendimi i punës me ministrinë përgjegjëse për financat dhe institucionet bankare;

2.8. Regjistrimi i të hyrave dhe donacioneve të ndryshme si dhe regjistrimi i të dhënave kontabël;

2.9. Përgatitja e analizave buxhetore si dhe raporteve periodike mbi shpenzimin e buxhetit dhe monitorimi i realizimit të projekteve të cilat janë të lidhura me buxhetin e AIE-së;

2.10. Krijimi i një sistemi për njohjen e të gjitha shumave dhe për regjistrimin në librin e veçantë të borxheve;

2.11. Kontrollimi i rregullt i librit të borxheve dhe planifikimi i aktiviteteve për mbledhjen e borxheve të vonuara;

2.12. Përpilimi i raporteve periodike për nivelin e borxheve, duke u bazuar në të dhënat e AIE-së dhe të dhënave nga Thesari.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Buxhet dhe Financa raporton tek Drejtori Ekzekutiv i AIE-së.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Buxhet dhe Financa është tre (3).

Neni 22

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

1. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka për mision të sigurojë menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore përmes zhvillimit të procedurave, programeve dhe shërbimeve që kontribuojnë në shpërndarjen e detyrave dhe përgjegjësi në mënyrë të balancuar për nëpunësit e institucionit.

2. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

2.1. Mbështetja dhe ofrimi i këshillave për Drejtorin Ekzekutiv për menaxhimin e burimeve njerëzore;

2.2. Sigurimi dhe ushtrimi i kompetencave në përputhje me autorizimet dhe përgjegjësitë në funksion të zbatimit të legjislacionit, dokumenteve, kërkesave, procedurave dhe standardeve për institucionin në fushën e burimeve njerëzore;

2.3. Administrimi i dosjeve të nëpunësve civilë të AIE-së;

2.4. Përgatitja e Planit vjetor dhe planit afatmesëm të personelit, në pajtim me procesin e planifikimit buxhetor të institucionit;

2.5. Ofrimi i ndihmës për njësitë përkatëse në përgatitjen e përshkrimit të vendeve të punës, klasifikimin e vendeve të punës dhe sistematizimin e vendeve të punë;

2.6. Në bashkërendim me udhëheqësit e njësive, identifikimi dhe vlerësimi në mënyrë periodike i nevojave për aftësimin e nëpunësve civil të institucionit si dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve;

2.7. Monitorimi i zbatimit të planit të trajnimeve të personelit të AIE-së;

2.8. Menaxhimi i proceseve që lidhen me emërimet, lirimet, transferimet, pezullimet, pensionimin, konfirmimet e nëpunësve civilë në Agjenci dhe kategorive tjera në kuptimin e ligjit përkatës për zyrtarët publik;

2.9. Sigurimi i zbatimit të procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë si dhe

vijueshmërisë në punë;

2.10. Menaxhimi i procedurave disiplinore dhe procedurave të ankesave dhe kontesteve për nëpunësit civil dhe zyrtarët publik;

2.11. Hartimi i raportit vjetor dhe planit të punës për menaxhimin e burimeve njerëzore.

3. Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore raporton tek Drejtori Ekzekutiv i AIE.

4. Numri i të punësuarve në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është tre (3).

Neni 23

Divizioni për Prokurim Publik

1. Divizioni për Prokurim Publik ka për mision kryerjen e të gjitha procedurave të prokurimit publik për nevoja të AIE-së, në mënyrë efikase dhe transparente duke siguruar shfrytëzimin e drejtë të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të AIE-së si dhe duke i'u përmbajtur legjislacionit në fuqi.

2. Divizioni për Prokurim Publik ka detyrat dhe përgjegjësitë vijuese:

2.1. Përgatitja, koordinimi dhe zbatimi i planit vjetor të AIE-së në fushën e prokurimit publik;

2.2. Zhvillimi dhe zbatimi i procedurave të prokurimit të mallrave, punëve dhe shërbimeve;

2.3. Sigurimi që të gjitha kërkesat përgatiten dhe procedurat e prokurimit zhvillohen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;

2.4. Ofrimi i këshillave dhe asistimi i Drejtorit Ekzekutiv dhe njësive tjera të AIE-së në marrjen e vendimeve lidhur me procedurat e prokurimit, dhe

2.5. Përgatitja e raporteve të prokurimit sipas legjislacionit në fuqi.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Prokurim Publik raporton te Drejtori Ekzekutiv.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Prokurim Publik është tre (3).

Neni 24

Njësia e Auditimit të Brendshëm

1. Njësia e Auditimit të Brendshëm ka për mision ofrimin e kontributit në përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm të financave publike me qëllim të përmirësimit të qeverisjes dhe mbrojtjen e interesave të taksapaguesve.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm janë:

- 2.1. Hartimi dhe dorëzimi i Planit Vjetor të Auditimit të Brendshëm;
- 2.2. Ndërmarrja e auditimeve të rregullta dhe sistematike në Agjenci, në përputhje me Ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe rregullat tjera, si dhe standardet e zbatueshme për Agjencinë;
- 2.3. Verifikimi i ekzistimit dhe zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm të AIE-së dhe cilësisë së saj;
- 2.4. Identifikimi i mangësive substanciale në sistemin e menaxhimit të AIE-së;
- 2.5. Verifikimi i përputhshmërisë së procedurave të AIE-së me rregullat e zbatueshme për AIE-së;
- 2.6. Ekzaminimi i të gjitha funksioneve operative të AIE-së;
- 2.7. Verifikimi se të gjitha llogaritë janë të sakta, të plota, me kohë, duke përfshirë besueshmërinë dhe plotësinë e informacionit të kontabilitetit;
- 2.8. Marrja e informatave të mjaftueshme, të përshtatshme, të rëndësishme dhe të përdorshme si bazë për të gjeturat e auditimit dhe rekomandimet;
- 2.9. Auditim duke vlerësuar ekonomizimin, efikasitetin dhe efektivitetin e sistemeve të menaxhimit dhe të kontrollit të njësive të AIE-së;
- 2.10. Ofrimi i rekomandimeve për përmirësimin në ngritjen e ekonomizimit, efikasitetit dhe efektivitetit të veprimtarive të AIE-së;
- 2.11. Ofrimi i këshillave për zhvillimin e rregullave organizative të AIE-së dhe për vlerësimin e efikasitetit të masave të propozuara;
- 2.12. Bashkëpunimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit, Komitetin e Auditimit të Brendshëm të Zyrës së Kryeministrit dhe Departamentin Qendror Harmonizues të ministrisë përgjegjëse për financa;
- 2.13. Hartimi dhe dorëzimi i raporteve periodike dhe vjetore të auditimit të brendshëm, dhe
- 2.14. Monitorimi i raporteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, Autoritetit të Auditimit dhe trupave të tjera të autorizuar të auditimit, dhe adresimi si dhe monitorimi i rekomandimeve nga këto raporte.

3. Udhëheqësi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm raporton tek Kryeministri.

4. Numri i të punësuarve në Njësinë e Auditimit të Brendshëm është tre (3).

Neni 25

Divizioni për Teknologji Informative, Logjistikë dhe Arkivim

1. Divizioni për Teknologji Informative, Logjistikë dhe Arkivim ka për mision të ofrojë

mbështetje administrative dhe shërbime të përgjithshme për njësitë e tjera organizative, për sigurimin e funksionimit të rregullt të AIE-së.

2. Divizioni për Teknologji Informative, Logjistikë dhe Arkivim ka detyrat dhe përgjegjësitë vijuese:

2.1. Menaxhimi, koordinimi dhe ofrimi i shërbimeve administrative, përfshirë teknologjinë informative, për të gjitha njësitë dhe organet në kuadër të AIE-së;

2.2. Ofrimi i shërbimeve të përbashkëta për të gjithë personelin e AIE-së;

2.3. Sigurimi i funksionimit të logjistikës, transportit, depove, materialeve për zyre, dokumentacionit, dhe infrastrukturës së AIE-së.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Teknologji Informative, Logjistikë dhe Arkivim i raporton Drejtorit Ekzekutiv të AIE-së.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Teknologji Informative, Logjistikë dhe Arkivim është katër (4).

Neni 26

Divizioni për Komunikim dhe Marketing

1. Divizioni për Komunikim dhe Marketing ka për mision rritjen e transparencës së punës së AIE-së përmes komunikimit të hapur me publikun, objektiv dhe të paanshëm, të qartë, të përgjegjshëm dhe në kohë, duke siguruar pjesëmarrje aktive të publikut në zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi të AIE-së.

2. Divizioni për Komunikim dhe Marketing ka detyrat dhe përgjegjësitë në vijim:

2.1. Ofrimi i përkrahjes profesionale për Drejtorin Ekzekutiv, duke ofruar këshilla për efektivitet të prezantimit të politikave;

2.2. Përgatitja dhe shpërndarja e komunikatave për shtyp, deklaratave, raporteve dhe publikimeve tjera të AIE-së për publikun;

2.3. Koordinimi me Zyrën e Komunikimit Publik të Zyrës së Kryeministrit, për komunikimin efektiv me publikun;

2.4. Përgatitja, shpërndarja dhe arkivimi i fotografive dhe materialeve audio-vizuele të aktiviteteve kryesore të AIE-së;

2.5. Përgatitja e raporteve të komunikimit publik sipas legjislacionit në fuqi;

2.6. Përditësimi, sigurimi i qasjes dhe kredibilitetit të informatave në ueb-faqen zyrtare të AIE-së dhe menaxhimi me llogarinë elektronike zyrtare për komunikim me publikun;

2.7. Menaxhimi i komunikimit të AIE-së në llogarinë zyrtare të institucionit në rrjetet sociale;

2.8. Zhvillon dhe menaxhon brendin dhe imazhin e vendit në lidhje me promovimin e

investimeve dhe të eksportit;

2.9. Zhvillon materialet e marketingut duke përfshirë por pa u limituar në broshura, video, prezantime dhe materiale të cilat ofrojnë informata mbi mundësitë e investimeve dhe eksportit;

2.10. Zhvillon strategji të marketingut që ndërlidhen me objektivat e përgjithshme të AIE-së;

2.11. Zhvillon dhe administron identitetin tregtar të AIE-së;

2.12. Ofron mbështetje për krijimin dhe menaxhimin e fushatave promovuese nëpërmjet kanaleve të ndryshme;

2.13. Ofron mbështetje për përmbajtjen e aktiviteteve të AIE-së, duke siguruar konsistencë në përcimin e mesazheve, dhe shfaqja e tyre në ueb faqe, rrjete sociale, fletushka, broshura etj;

2.14. Organizon dhe koordinon ngjarje dhe ekspozimin e aktiviteteve të AIE-së;

2.15. Zhvillon strategji për mirëmbajtjen e investimeve dhe eksporteve;

2.16. Përdorë mjete analitike për matjen e performancës së marketingut;

2.17. Ofron mbështetje të vazhdueshme ndaj strukturave të AIE-së, në veçanti të Zyrës për Investime dhe Zyrës për Eksport.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Komunikim dhe Marketing raporton tek Drejtori Ekzekutiv i AIE-së.

4. Numri i të punësuarve në Divizion për Komunikim dhe Marketing është pesë (5).

Neni 27 Shtojcat

Shpërndarja e vendeve të punës në klasa dhe grupe të administrimit tek njësitë administrative të AIE-së përcaktohet në Shtojcën 1 dhe organogrami i AIE-së në Shtojcën 2, të cilat janë pjesë përbërëse të kësaj Rregulloreje.

Neni 28 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

14 janar 2026

Shtojca 1

Vendet e Punës së Agjencisë së Investimeve dhe Eksportit			
Pozicioni/struktura	Klasa	Grupi (i përgjithshëm ose i veçantë)	Numri
1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv			Totali: 5
i. Drejtori Ekzekutiv	Drejtues i Lartë	N/N	1
ii. Zëvendës-Drejtori Ekzekutiv	Drejtues i Lartë	N/N	1
iii. Zyrtar i Lartë Ekzekutiv	Profesional 1	G12 – grupi i shkencave shoqërore	1
iv. Zyrtar i Lartë Certifikues	Profesional 1	SHC-0167 – grupi i ekonomisë	1
v. Zyrtar Administrativ	Profesional 2	G63 – grupi i administrimit të përgjithshëm	1
2. Zyra për Promovimin e Investimeve dhe Eksportit			Totali: 13
i. Drejtor i Zyrës	Drejtues i Mesëm	N/N	1
2.1. Divizioni i Promovimit të Investimeve			
i. Udhëheqës divizioni	Drejtues i Ulët	N/N	1

ii. Zyrtar i Lartë për Promovim të Investimeve	Profesional 1	G63 - Grupi i administrimit të përgjithshëm	6
2.2. Divizioni i Promovimit të Eksportit			
i. Udhëheqës Divizioni	Drejtues i Ulët	N/N	1
ii. Zyrtar i Lartë për Promovim të Eksportit	Profesional 1	G63 – Grupi i administrimit të përgjithshëm	4
3. Zyra për Hulumtim dhe Zhvillim të Sektorëve			Totali: 11
i. Drejtor i Zyrës	Drejtues i Mesëm	N/N	1
3.1. Divizioni për Hulumtim dhe Analizë të Sektorëve			
i. Udhëheqës Divizioni	Drejtues i Ulët	N/N	1
ii. Zyrtar i Lartë për Hulumtim dhe Analizë	Profesional 1	G63 – Grupi i administrimit të përgjithshëm	4
3.2. Divizioni për Zhvillim të Sektorëve			
i. Udhëheqës Divizioni	Drejtues i Ulët	N/N	1
ii. Zyrtar i Lartë për Zhvillim të Sektorëve	Profesional 1	G63 – Grupi i administrimit të përgjithshëm	4
4. Zyra për Shërbime			Totali: 10
i. Drejtor i Zyrës	Drejtues i Mesëm	N/N	1

4.1. Divizioni për Lehtësim			
i. Udhëheqës Divizioni	Drejtues i Ulët	N/N	1
ii. Zyrtar i Lartë për Lehtësim	Profesional 1	G63 – Grupi i administrimit të përgjithshëm	2
4.2. Divizioni për Investime Strategjike			
i. Udhëheqës Divizioni	Drejtues i Ulët	N/N	1
ii. Zyrtar i Lartë për Investime Strategjike	Profesional 1	G63 – Grupi i administrimit të përgjithshëm	2
4.3. Divizioni për Kujdesin Pasues			
i. Udhëheqës Divizioni	Drejtues i Ulët	N/N	1
ii. Zyrtar i Lartë për kujdesin pasues	Profesional 1	G63 – Grupi i administrimit të përgjithshëm	2
5. Zyra Ligjore			Totali: 7
i. Drejtor i Zyrës	Drejtues i Mesëm	N/N	1
5.1. Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit			
i. Udhëheqës Divizioni	Drejtues i Ulët	N/N	1
ii. Zyrtar i Lartë Ligjor për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit	Profesional 1	G1 – grupi ligjor	2
5.2. Divizioni për Këshillimin Ligjor në Fushën e Investimeve dhe Eksporteve			

i. Udhëheqës Divizioni	Drejtues i Ulët	N/N	1
ii. Zyrtar i Lartë ligjor	Profesional 1	G1 – grupi ligjor	2
6. Divizioni për Buxhet dhe Financa			Totali: 3
i. Udhëheqës Divizioni	Drejtues i Ulët	N/N	1
ii. Zyrtar i Lartë për buxhet dhe financa	Profesional 1	G2 – grupi i buxhetit dhe financave	2
7. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore			Totali: 3
i. Udhëheqës Divizioni	Drejtues i Ulët	N/N	1
ii. Zyrtar i Lartë i burimeve njerëzore	Profesional 1	G6 – grupi i burimeve njerëzore	2
8. Divizioni për Prokurim Publik			Totali: 3
i. Udhëheqës Divizioni	Drejtues i Ulët	N/N	1
ii. Zyrtar i Lartë për prokurim	Profesional 1	G4 – grupi i prokurimit publik	2
9. Njësia e Auditimit të Brendshëm			Totali: 3
i. Udhëheqës Divizioni	Drejtues i Ulët	N/N	1
ii. Auditor i brendshëm	Profesional 1	G5 – grupi i auditimit të brendshëm	2

10. Divizioni për Teknologji Informative, Logjistikë dhe Arkivim			Totali: 4
i. Udhëheqës Divizioni	Drejtues i Ulët	N/N	1
ii. Zyrtar i Lartë për teknologji informative	Profesional 1	G49 – grupi i teknologjisë informative	1
iii. Zyrtar i Lartë për arkivë	Profesional 1	G7 – grupi i arkiv dokumentacionit	1
iv. Zyrtar për logjistikë	Profesional 2	G63 – grupi i administrimit të përgjithshëm	1
11. Divizioni për Komunikim dhe Marketing			Totali: 5
i. Udhëheqës Divizioni	Drejtues i Ulët	N/N	1
ii. Zyrtar i Lartë për komunikim me publikun	Profesional 1	G8 – grupi i marrëdhënieve me publikun dhe informim	2
iii. Zyrtar i Lartë për marketing	Profesional 1	G8 – grupi i marrëdhënieve me publikun dhe informim	2
Numri i Përgjithshëm i Stafit			67

ORGANOGRAMI I AGJENCISË PËR INVESTIME DHE EKSPORTE

